



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2020:183690

Datë: 29.03.2024

Numri i dokumentit: 05529168

KF.nr.121/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar - administrativ të paditësit “Adetex” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, rr. “Muharrem Fejza” pn, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson I.A., kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me paditën e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimor, në seancën e shqyrtimit kryesor-publik të mbajtur me 19.03.2024, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit I.A., e në mungesë të përfaqësueses së palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. Aprovohet si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit “Adetex” Sh.P.K. me seli në Prishtinë.
- II. Anulohet vendimi nr.prot.399/2020 i datës 04.12.2020 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë-Departamentit të Ankesave, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi me padinë e datës 23 Dhjetor 2020, ka iniciuar këtë konflikt tregtar administrativ kundër të paditërs Administratës Tatimore të Kosovës, duke kërkuar anulimin e vendimit të Departamentit të Ankesave, nr. 399/2020, datë 4 Dhjetor 2020. Argumentet e paditësit theksojnë se Administrata kishte bërë shkelje të rënda procedurale dhe profesionale në disa raste, duke

përfshirë aplikimin e dyfishtë të shitjeve, anulimin e faturave, dhe trajtimin e gabuar të huazimeve. Së pari, paditësi argumentoi se Administrata kishte aplikuar gabimisht një avans të dyfishtë në shitjet, duke i referuar këto si avanse të padeklaruara dhe duke krijuar një qarkullim shtesë të papranueshëm. Ai solli në vëmendje rastin konkret ku Administrata kishte bartur avansin e një shume prej 71,549.72 euro, kur në fakt, pas një ekzaminimi të hollësishëm, u zbulua se avansi ishte bartur dy herë. Më tej, në lidhje me anulimin e një fature të blerjeve nga subjekti Adeterm Sh.P.K., paditësi pretendon se Administrata kishte bërë një vlerësim të gabuar, duke mos marrë parasysh lidhjet profesionale që ekzistojnë dhe duke bërë një interpretim të gabuar të transaksioneve. Në aspektin e huazimeve të marra nga pronari dhe kthimeve të realizuara, paditësi sqaroi se në periudhën e pandemisë, për të vazhduar operacionet, ishin të nevojshme huazime, të cilat më pas ishin kthyer. Administrata, megjithatë, kishte trajtuar këto huazime në mënyrë të pasaktë si të ardhura, duke krijuar një pasqyrim të rremë financiar për kompaninë. Paditësi paraqiti një sërë dokumentacionesh dhe dëshmish, përfshirë Aktgjykime të Gjykatës dhe kontrata të huazimeve, si mbështetje për pretendimet e tij. Gjykatës i kërkoi që vendimi i Administratës Tatimore të anulohet dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek e paditura.

E paditura në përgjigjen në padi të datës 21.12.2021 e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar në ligj dhe fakte dhe vlerëson se vendimi i kontestuar ka mbështetje ligjore dhe faktike dhe është në harmoni të plotë me legjislacionin tatimor. Më tej ka shtuar se pas analizës së kartelës së Dukagjini Invest, verifikoi që avansi i vitit 2017 ishte pranuar dhe deklaruar si duhet për periudhat e TVSH-së dhe se kontrolli paraprak dhe ai në vijim kishte konfirmuar zbatimin e duhur të dispozitave ligjore. ATK theksoi se të ardhurat dhe dinamika e punimeve me Dukagjini Invest ishin vlerësuar në përputhje me legjislacionin dhe se diferenca prej 71,549.72 euro ishte konstatuar si e besueshme bazuar në punët e kontraktuara dhe verifikimet në terren. Për çështjet e tjera të ngritura nga paditësi, si anulimi i faturave dhe trajtimi i huazimeve, ATK argumentoi se kishte ndjekur procedurat ligjore dhe kishte bazuar vendimet e saj në analizën e provave dhe dokumentacionit të disponueshëm, duke konkluduar se paditësi nuk kishte respektuar legjislacionin tatimor në fuqi. Gjykatës i propozoi të refuzohet në tërësi si e pabazuar padia dhe të vërtetohet vendimi i DA nr.399/2020 i datës 04.12.2020.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor - publik të datës 21.03.2024, ka administruar provat si në vijim: Vendimi 399/2020 i dt 04.12.2020, Ankesa drejtuar DA në ATK dt 04.11.2020, Përshkrimi i kontrollit të kryer-dokumentimi i avanseve të pranuar me kontrollin paraprak, Kartelë financiare-paditësit me Dukagjini Invest Sh.p.k, Lista e punëtorëve të subjekti "Adeterm" periudha 2019, Raporti i kontrollit dt 12.10.2020, Deklaratë për konfirmimin e kartelës financiare për periudhën 01.01.2017-31.12.2019 me subjektin Adetex Sh.P.K, Aktgjykimi A.nr. 1387/2020, Email i dt 02.03.2021, Formularët e deklarimeve të TVSH-së: periudha 07.2017; periudha 10/2017; periudha 12/2019, Faturë nr. 40/2019; faturë nr. 19-BLN01-001-2, Deklarim i "Adeterm" periudha 2019, Faturë 19-SHNK1-001-1, LSH Adeterm 2019, Listën e punëtorëve për Adetex periudha 2019, Marrëveshje huazimi e datës 05.06.2020, Marrëveshje huazimi e datës 01.06.2020, Marrëveshje huazimi e datës 04.06.2020, Informatat për biznesin MC sh.p.k të printuara nga ARBK, Llogari bankare e printuar nga e-banking, Padi e datës 23.12.2020, Kontratë për furnizim dhe kryerje të punimeve Dukagjini dhe Adetex nr. i referencës 03/2017, Qarkullimi bankar për periudhën 01.02.2020-31.07.2020.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga vendimi i kontestuar i ATK-së me nr.126/2021 të datës 07.05.2021, gjykata konstaton se e paditura ATK ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit. E paditura në arsyetim të vendimit të kontestuar ka theksuar se Divizioni i Ankesave pasi analizoi kartelën e Dukagjini Invest Shpk për vitin 2017 dhe verifikoi se avansi prej 72,000€ i pranuar gjatë periudhave 10/2017, 11/2017 dhe 12/2017 ishte deklaruar korrekt nga subjekti. Kontrollat paraprake dhe ato në vijim konfirmuan zbatimin e ligjit mbi TVSH dhe rregullat e tjera të aplikueshme, duke e bërë vlerësimin për të ardhurat e vitit 2017 si të besueshëm. Sipas punimeve të kontraktuara, të ardhurat bruto ishin 470,646.69€ për atë vit, dhe diferenca e vlerësuar prej 71,549.72 € për periudhën CD 2019 u konfirmua si e saktë pas verifikimeve në teren. Për çështjen e anulimit të faturës nr. 19-SHNK1-001-1 nga Adeterm Shpk, Divizioni i Ankesave gjeti dallime në përshkrimet e faturave të inspektorit dhe të tatimpaguesit. Pavarësisht arsyetimeve të tatimpaguesit rreth pagesave dhe kontributeve të deklaruara, u konstatua se A,F, nuk kishte të

ardhura të paguara nga Adetex Shpk për vitin 2019. Ndërsa në lidhje me huazimet nga pronari dhe transferimet, u vërtetua se nuk janë plotësuar kriteret e parapara të ligjit 05/L-029 dhe të UA 02/2016 neni 7 njohja e të ardhurav të tatueshme duke marr vlerësimin e kontrollit si të besueshëm duke e përshkruar detajisht kronologjinë e huazimeve si në vijim: Me dt. 01.06.2020 nga përshkrimi Deponim 4.000€, në transfer qartë është definuar huazim pa interes dhe me dt. 12.10.2020 është bërë kthimi përmes llogarisë nga "Adetex" shpk te Agimi dhe nga Agimi tek huadhënësi përmes llogarisë bankare. Me dt. 04.06.2020 nga përshkrimi Deponim 9.800 € janë marrë për pagesat e pagave - shih historianin bankar dhe janë kthyer me dt. 29.06.2020. Me dt. 05.06.2020 nga përshkrimi Deponim 5,200€ dhe janë bërë transfer jo tek "Adetex" shpk por te MC SHPK nga llogaria individuale ku edhe është 50% në pronësi dhe janë kthyer me dt.12.10.2020 është bërë kthimi përmes llogarisë nga "Adetex" shpk te Agimi dhe nga Agimi tek huadhënësi.

Gjykata shqyrtoi ligjshmëria e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesës konform nenit 44 par 1. të LKA-së. Sipas nenit 43 par 2 të LKA-së, nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ.

Nga vendimi i kontestuar rezulton se ai përmban të meta të tilla që e bëjnë të pamundur vlerësimin e ligjshmërisë së tij. Gjykata gjen se vendimi i kontestuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare të vlefshme për zgjidhjen e çështjes në shqyrtim. Në fakt në vendimin e kontestuar përveç konstatimit se diferenca prej 71,549.72 € për periudhën CD 2019 u konfirmua si e saktë pas verifikimeve në teren, nuk argumenton fare pretendimet e paditësit dhe provat e parashtruara se avansi i mbetur është 59,000.00 siç shihet edhe nga prova e bashkangjitur shkresave të lëndës, respektivisht raporti i kontrollit për vitin 2019. Se ka mundësi të rishikimit të kësaj pike, gjykata po ashtu e vlerësoi kur administroi korrespondencën elektronike midis këtu paditësit dhe avokatit tatimor pranë të paditurës, sipas të cilit rezulton se të njëjtit janë të gatshëm të rishikojnë raportin lidhur me gjetjet e kësaj pike. Gjithashtu, gjykata gjen se vendimi i

kontestuar nuk përmban arsye për faktet vendimtare të vlefshme për zgjidhjen e çështjes në shqyrtim lidhur me anulimin e faturës kontestuese ku e paditura bazohet se fatura nga inspektori dhe fatura nga tatimpaguesi kanë përshkrime të ndryshme, mirëpo nuk sqaron nëse TVSH-ja është paguar nga cilido qoftë biznes, nëse e njëjta ishte e deklaruar siç pretendon paditësi dhe cili nga paragrafët e nenit 45 të Ligjit për Administratën Tatimore është i zbatueshëm në rastin konkret. Më tej për gjykatën rezultojnë të jetë i paqartë arsyetimi i të paditurës lidhur me huazimet e trajtuara si qarkullim shtesë, kjo për faktin se e njëjta nuk ka ofruar arsyetim të mjaftueshëm nëse janë analizuar kontratat e ofruara nga paditësi. Gjykata konstaton se vetëm janë përshkruar lëvizjet në llogari, mirëpo nuk është sqaruar cila është arsyeja e mos njohjes së këtyre huazimeve. Nga ekzaminimi i listës së punëtorëve, konstatohet se sipas listës së deklaruar A,F, në vitin 2019 nuk ka qenë i punësuar në biznesin e paditësit Adetex, por ka figuruar në listën e pagave të biznesit Adeterm. Edhe në këtë pikë gjykata e ka të paqartë vlerësimin e të paditurës se A,F, nuk ka të paguara të ardhurat e tij për vitin 2019, tatimin synues për muajt e caktuar si dhe kontributet pensionale, duke mos e sqaruar se nga është marr informacioni se i njëjti ka qenë i punësuar tek paditësi në vitin 2019, kur e paditura në shkresa të lëndës ka bashkangjitur listën e punëtorëve për vitin 2020, në të cilën A,F, figuron si i punësuar, mirëpo kjo nuk e arsyeton vlerësimin e të njëjtës se A,F, ka qenë i punësuar tek paditësi në vitin 2019.

Rrjedhimisht, gjykata e obligon të paditurën që në rishqyrtim dhe rivendosje që fillimisht të deklarohet se mbi bazën e cilave provave dhe fakteve relevante e ka vërtetuar faktin se paditësi ka avanse shtesë siç ka konstatuar në vendim, të deklarohet lidhur me anulimin e faturës kontestuese, nëse e njëjta ka qenë e deklaruar nga paditësi dhe nëse jo a e ka kërkuar informatën nëse fatura me ngareksë të kundërt është deklaruar nga dhënësi i shërbimeve, të specifikoj arsyen e anulimit të së njëjtës, dhe së fundi të deklarohet lidhur me huazimet dhe tatimin në të ardhura për punëtorin A,F,, se mbi cilat prova materiale e ka mbështetur vlerësimin e vet.

Gjykata vlerëson se të metat e lartcekur janë të tilla që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, kështu që gjykata e obligon të paditurën që në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura, të marr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Vërejtjet e cekura janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Vendimin që secila palë ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka marr konform nenit 64 të LKA-së nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Nga të cekurat më lart gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 43 par.2 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal
KF.nr.121/22, datë 29.03.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj Gjykate.